



## Pluttra – informata për kujdestarët

### **Mjeti për dokumentim dhe informim parashkollor**

Pluttra është zhvilluar për parashkollat nga Lin Education. Është platformë miqësore për përdoruesit për të ndarë dokumente dhe informata me kudestarët në shtëpi. Dokumentacioni mund të përmbajë tekste, foto, audio dhe video. Meqenëse Pluttra nuk kërkon platformë specifike, mund të përdoret në smart telefone, tableta dhe kompjutera.

Pluttra ka potencial për të përmirësuar kontaktin ndërmjet parashkollave dhe kujdestarëve në shtëpi. Si kujdestar, mund të shihni momente nga dita e fëmijës suaj në kopshtin parashkollor, si dhe të dëgjoni reflektimet e mësuesve lidhur me punën arsimore parashkollore. Ju gjithashtu do të merrni mesazhe të rëndësishme dhe do të keni mundësi të regjistroheshi në kalendarin e grupit.

Është e rëndësishme që ju si kujdestar të ndiheni i sigurt duke përdorur Pluttrën. Vetëm ju keni qasje në dokumentacionin e fëmijës suaj. Siguria është prioritet i lartë në Pluttra – çdo gjë që publikohet nga parashkolla është në pronësi të tyre dhe në të kanë qasje vetëm stafi parashkollor dhe ju si kujdestar.

### **Si të krijoni llogarinë tuaj personale**

- Parashkolla ju dërgon një ftesë në postën tuaj elektronike
- Klikoni linkun në ftesë
- Futni informacionin tuaj dhe zgjidhni një fjalëkalim
- Pastaj klikoni në ikonën Pluttra
- Hapi i radhës është shkarkimi i aplikacionit të kujdestarit

### **Pluttra app**

Ju mund të shkarkoni aplikacionin nga Google Play për Android dhe AppStore për iOS. Aplikacioni është pa pagesë. Identifikohu duke përdorur fjalëkalimin që e keni specifikuar gjatë krijimit të llogarisë tuaj personale.

Për të kuptuar më mirë Pluttrën, ne kemi prodhuar disa filma që mund t'i gjeni këtu (në gjuhën suedeze):

[https://www.youtube.com/playlist?list=PLyfy2\\_IH9nwcZU9oWlseeavVpVOs1vi0](https://www.youtube.com/playlist?list=PLyfy2_IH9nwcZU9oWlseeavVpVOs1vi0)

### **Pluttra Support**

Ekipi i mbështetjes së Pluttrës flet suedisht dhe anglisht.

Orari i punës: gjatë ditëve të javës prej 08:00 deri 17:00

E-mail: [produktsupport@lineducation.se](mailto:produktsupport@lineducation.se)

Telefon: +46 (0)10-209 63 10

### **Siguria në Pluttra**

Ofruesit tanë të serverëve janë PIN dhe Glesys. Pluttra ruan të dhënat çdo natë dhe këto të dhëna ruhen në Suedi.

Është nënshkruar një marrëveshje midis arsimit parashkollor dhe Lin Education që t'i siguroj të dhënat në përputhje me Aktin suedez të të dhënave personale. Nënshkrimi i marrëveshjeve po ashtu përfshinë marrëveshjen për përpunimin e të dhënave. Kjo marrëveshje siguron që ne t'i trajtojmë të dhënat personale në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti përgjegjës.

Identifikimi mbrohet nga SSL, i cili është i njëjti nivel mbrojtjeje i përdorur nga bankat dhe e-commerce për të siguruar fjalëkalimet dhe të dhënat e ndjeshme.

Çdo gjë që parashkollat publikojnë në Pluttra ka qasje vetëm drejtori i parashkollës dhe mësuesit. Kujdesi parashkollor mban të gjitha të drejtat për të gjithë përmbajtjen e tij në Pluttra, gjegjësisht tekste, foto, video dhe audio. Dokumentacioni për fëmijët individualë është i arritshëm vetëm për përdoruesit të cilët janë të regjistruar dhe të lidhur me grupin, si dhe kujdestarin e fëmijës. Një listë e shpejtë referimi e bën të lehtë që mësuesit e grupit të mbajnë evidencë se cilët fëmijë lejohen të fotografohen në përputhje me pëlqimin e kujdestarit.

Ky informacion është në dispozicion në këto gjuhë: suedisht, anglisht, arabisht, farsi, dari, kurmandji, tigrinja dhe në gjuhën somaleze.

Më shumë informacion në suedisht mund të gjeni në <http://www.lineducation.se/pluttra>